

UDHËZIM
Nr. 4, datë 11.4.2016

PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT
FILLOR 2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 dhe 49, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2010, "Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA)", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit",

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, në datën 23 maj 2016, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
2. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10:00 dhe të zgjat 1 orë e 30 minuta.
3. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren "Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2016".
4. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me veçoritë dhe standardin tyre.
5. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, tërheq testin në AKP, një ditë para zhvillimit të vlerësimit, dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.
6. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.
7. Arkivimi i testeve bëhet pranë DAR/ZA-ve.
8. Sektori i Statistikës i DAR/ZA-së merr nga QVT-ja dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në AKP, ISHA dhe MAS.

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla